

Aplikacioni HealthBuddy+ për COVID-19

Aplikacioni HealthBuddy+ është një mjet digjital interaktiv në internet që ofron qasje në informata të përditësuara dhe të bazuara në prova mbi COVID-19, duke përfshirë vaksinimin. HealthBuddy+ tashmë është në dispozicion në gjuhën Shqipe dhe Serbe falë mbështetjes së Zyrës së OBSH-së në Prishtinë.

Aplikacioni është zhvilluar nga zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën (OBSH/Evropë) dhe Zyra Rajonale e UNICEF-it për Evropën dhe Azinë Qendrore (UNICEF ZREAQ), dhe është krijuar për të mbështetur qasje në informata të besueshme për COVID-19. I njëjti aplikacion është i disponueshëm për të gjitha vendet e rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore në gjuhët e tyre lokale.

HealthBuddy+ është në dispozicion në ueb, dhe si aplikacion celular (në dyqanet e aplikacioneve Apple dhe Google Play) dhe ka disa veçori. Në versionin e uebit, përdoruesi mund të ndërvepron me chatbot për të marrë përgjigje për COVID-19.

Nëpërmjet aplikacionit celular HealthBuddy+, përdoruesit mund të: bëjnë pyetje për COVID-19 në chatbot dhe të marrin përgjigje të verifikuara të menjëhershme; raportojnë thashethemet që qarkullojnë në komunitet; dhe ndajnë mendimet dhe përvojat mbi përgjigjen ndaj COVID-19 duke përdorur funksionin e sondazheve. I gjithë informacioni i disponueshëm në HealthBuddy+ nga përdoruesit kontrollohet nga ekipi i ekspertëve nga OBSH, dhe të gjitha informatat dhe provat e reja i shtohen rregullisht bot-it, bazuar në pyetjet dhe të dhënat përkatëse.

Gjeni më shumë informata për HealthBuddy+, shikoni videon më poshtë:

[HealthBuddy+ Miku juaj personal për informacione rreth COVID-19. - YouTube](#) (Titra Anglisht)

[HealthBuddy+ Miku juaj personal për informacione rreth COVID-19. - YouTube](#) (Titra Serbisht)

Për më shumë informata mbi aplikacionin, kontaktoni:

E-mail: humollii@who.int (OBSH)

E-mail: dzuna@unicef.org (UNICEF)

Platforma HB+ është e ndërlidhur me ueb-sajtet në vijim:

Ueb-sajti i Institutit të Shëndetit Publik, chatbot-i është i integruar:

[IKShPK – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike \(niph-rks.org\)](http://IKShPK.org)

Në ueb-sajtin e Odës së Mjekëve, mund të gjendet përmes:

<https://omk-rks.org/platforma-healthbuddy-eksperti-yt-personal-per-covid-19/>

dhe <https://omk-rks.org/vegeza/>

UNKT ueb-sajti, nga 2 nëntor 2020:

[Take Action | United Nations in Kosovo](#)

UNICEF ueb-sajt:

[Take action | UNICEF Kosovo Programme](#)